

AKT THEMELIMI

I SHOQËRISË TREGTARE “MEGA STORE SHOES” SH.P.K ME SELI NË TIRANË

Sot, më datë 15.12.2023 në Tiranë,

Znj. Leonora Bami shtetase shqiptare, e lindur më 28.10.1993 në Kruje, Shqiperi, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me numer personal J36028050P.

E cila ka vendosur themelimin e shoqërisë **Mega Store Shoes shpk** shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, me termat e mëposhtme:

NENI 1

Shoqeria **Mega Store Shoes shpk** është formuar si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901 e datës 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, (në vazhdim Shoqëria).

Shoqëria është Person Juridik Privat . Shoqëria ka selinë e saj në Tiranë dhe do të mund të vendos ose heq seli sekondare, zyra sekondare përfaqesimi dhe agjenci në Shqipëri edhe jashtë shtetit.

NENI 2

Emri i shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin **Mega Store Shoes shpk**

NENI 3

Objekti i veprimtarisë

Shoqeria ka për objekt - në përpunje me kërkesat ligjore - veprimtaritë e mëposhtme:

Kompania ka për objekt tregtimin me shumicë dhe me pakicë të këpucëve, veshje dhe kostumesh, aksesore veshjeje, artikujt e leshit; këmisha, rroba të brendshme, trikota dhe të ngjashme; artikujt e leshit; perfume dhe kozmetikë; artikujt e lëkurës; artikujt për shtëpinë;, tekstilet dhe qilimat; artikujt e mobilimit; artikujt e veshjes per evenete specifike; artikujt e plastikës dhe drurit; artikujt e mobilimit të brendshëm dhe të jashtëm; lodra, lojra dhe artikuj kancelarik; artikujt sportivë; artikujt e udhëtimit; elektrodomestikë të vegjël; produkte për higjienën e personit dhe shtëpisë, artikujt e dhuratave; materialet elektrike dhe elektronike për përdorim në shtëpi; artikujt e qeramikës dhe porcelanit, thika, vreshta dhe enë gatimi,artikujt mjekësorë dhe ortopedikë, orë dhe artikujt bizhuterie; përfaqësimin tregtar, me ose pa kapar, të produkteve të përmendura më sipër; Menaxhimin I subjekteve dhe dyqaneve jo te specializuara për ushqime.

Kompania synon gjithashtu të operojë në fushën e normave që rregullojnë veprimtarinë e kompanive tregtare; gjithashtu synon të përfitojë nga të gjitha lehtesirat tatimore, kreditore dhe financiare të parashikuara nga të gjitha dispozitat ligjore aktuale në lidhje me këtë fushe. Kompania mund gjithashtu të kryejë të gjitha operacionet tregtare dhe financiare të nevojshme për arritjen e qëllimeve sociale të saj dhe gjithashtu mund të zhvillojë projekte me synim të marrjes së financimeve në bazë të rregullave të financimit specifike të dedikuara për sektorët e ndryshëm të siperpermendur. Kompania mund të pranojë dhe të jetë garant ne procese te huadhenies/marrjes.

NENI 4 **Selia e Shoqërisë**

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën : Rr."Sami Frasherri" Pallati Titan Konstruksion,Godina nr.8.9.20.11.12, Kati 2, Njesia Administrative Nr.10, zona Ish Eksposita, Tirane , Shqiperi

NENI 5 **Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie në para në vlerën 100 (njëqind) lek, dhe është i ndarë në 1 kuote.

Themeluesit marrin në pronësi kuotat e tyre në kapitalin themeltar në përputhje me kontributin e tyre.

Kontributi i ortakëve themelues në kapitalin themeltar është si më poshtë:

Znj.Leonora Bami 1 kuotë, me vlerë 100 Lekë, zotëron 100%

NENI 6 **Kohëzgjatja e shoqërisë**

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar.

NENI 7 **Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve;
2. Administratori .

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë. Shoqëria do të administrohet fillimisht nga Administratori i vetem i cili zgjidhet me afat pesëvjeçar të ripërtërishëm përvèç rasteve të revokimit ose të dorëheqjes ose shkaqeve të tjera ligjore.

Administratori i Shoqërisë do të jetë **Znj.Leonora Bami** shtetase shqiptare, e lindur më 28.10.1993 në Kruje, Shqiperi, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me numer personal J36028050P.



Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratorët, të cilët i ushtrojnë këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

Shoqëria është e administruar nga një administrator i vetëm, edhe jo ortak ose nga shumë administrator, edhe jo ortak, sipas asaj që është përcaktuar në aktin e emërimit.

Kur administrimi i shoqërisë i është besuar disa personave, akti i emërimit vendos në alternative:
a) nëse administratorët do të veprojnë në mënyrë kolegiale duke themeluar kështu këshillin e administritmit

b) nëse administrimi është caktuar bashkarisht ose jo bashkarisht.

NENI 8

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe Statutit.

NENI 9

Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 10

Ligji i aplikueshëm

Veprimtaria e shoqërisë rregullohet nga rregullat e Statutit të firmosur nga ortakët themelues sipas parashikimeve të ligjit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 11

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me themelimin e Shoqërisë do të zgjidhen nga Ortakët, në rast të kundërt do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Tiranë.

NENI 12

Dispozitat përfundimtare

Akt Themelimi hartohet në katër kopje në gjuhën shqipe dhe u lexua nga Ortakët Themelues, te cilët e gjetën atë në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe e nënshkruan pa vërejtje.

ORTAKU THEMELUES

LEONORA BAMI

